



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:074776

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05762931

P.nr.28/2024

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan-dega në Kamenicë, përmes gjyqtarit Sadri Krasniqi, me bashkëpunëtoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në çështjen penale kundër të akuzuarit, R. B. nga, për shkak të veprës penale, kontrabandimi me mallra nga neni 311 paragrafi 2 i KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan PP.II.nr.290 /2024, të datës 05.03.2024, në shqyrtimin e hapur gjyqësor, në prezencën e prokurores së shtetit Huma Jetishi, të akuzuarit R. B., më datë 14.05.2024, publikisht shpalli dhe komunikoi, ndërsa më datë 31.05.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **R.B.**, pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga babai A. dhe e ëma H., e lindur H., i lindur më datë në, me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i tre fëmijëve, i pa punësuar, i gjendjes jo të mirë ekonomike, sipas deklaratës së tij nuk ka qenë i dënuar më parë për veprë tjetër penale, ndërsa nuk udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale.

Është fajtor

Sepse më datë 25.02.2024, rreth orës 12:30 minuta, në vendin e quajtur „.....” në, përgjatë brezit kufitar, Kosovë –Serbi, i pandehuri R.B., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për veti apo për tjetrin, ka kontrabanduar mall- drunjë, nga Republika e Serbisë në Republikën e Kosovës- ashtu që patrulla e policisë kufitare SPMK- Muqiverc, gjatë implementimit të planit operativ “” në dy lokacione të ndara kanë hasur drunjë të prera, në sasi prej të 15.38 m3, të llojit Ah, plep dardhë dhe qershi, të cilat drunjë i pandehuri i ka sjellur , nga R. e Serbisë , rrugëve ilegale , pa asnjë dokumentacion valid, mbi prejardhjen e

tyre,të cilat drunjë i janë sekuestruar, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e tija, për t'iu shmangur kontrollit doganor përmes rrugëve ilegale ka bërë bartjen e masës drurore në fjalë, duke i shkaktuar buxhetit të Republikës së Kosovës dëm në vlerë 137.50. euro.

- Me çka ka kryer veprën penale, Kontarabandim me mallra, nga neni 311 paragrafi 2 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit të lartë cekur dhe neneve 4, 38, 39, 43, 69, 70 dhe 71 të KPRK-së, lidhur me nenin 242, 364 dhe 452 të KPPRK-së, të akuzuarin R.B. e,

G J Y K O N

Me dënim gjobë; (në të holla) në shumë prej **200 € (dyqind euro)**, të cilin dënim ka për ta arkëtuar në afatin prej 15 dite nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, në këste mujore, në të kundërtën dënimi me gjobë të njëjtit do ti zëvendësohet me dënim burgu ashtu që për çdo 20 €, do ti llogaritet nga një ditë burg.

Detyrohet i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Njashtu i akuzuari detyrohet që në kuptim të nenit 36 parag.3 nën parag. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.290/2024, të datës 05.03.2024, ka propozuar që ndaj të akuzuarit R. B. nga, të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprës penale: Kontarabandim me mallra, nga neni 311 paragrafi 2 të KPRK-së, të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe pas vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës, konstatoi se e aktakuza është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim fillestar, kundër të akuzuarit R. B. me datën 14.05.2024, në të cilën seancë gjyqësore, pas leximit të aktakuzës nga prokurorja e shtetit, i akuzuari R. B.ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, ndaj ka deklaruar se e pranon fajësinë, për veprën penale për të cilën akuzohet nga prokuroria e shtetit, duke theksuar se ka gabuar, është penduar, këtë veprë e ka bërë për shkak të kushteve të vështira

ekonomike në të cilat jeton, drutë i ka pas për nevoja familjare, sepse nuk ka mundësi me i ble, andaj nga gjykata ka kërkuar që nëse eventualisht shpallet fajtor të ketë parasysh gjendjen e vështirë ekonomike në të cilën jeton, sepse si prind i tre fëmijëve të mitur, jeton në kushte të vështira ekonomike, e po ashtu i premtoj gjykatës se nuk do të kryej më këso vepra apo vepra tjera penale, në mënyrë që mundësisht të më shqiptoj një dënim sa më të butë konform ligjit.

Prokurorja e shtetit Huma Jetishi, nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë, njëherit theksoj se janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë nga i akuzuari përkitazi me veprën penale me të cilën akuzohet sipas aktit akuzues.

Gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: - se i akuzuari R.B., me dashje ka kryer veprën penale, Kontarabandim me mallra, nga neni 311 paragrafi 2 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për të cilën vepër penale, gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës. Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë, gjykata nuk është lëshuar fare në administrimin e provave të propozuara si në aktakuzë.

Gjykata me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të akuzuarit për veprën penale të kryer, vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në shqiptimin e drejtë dhe meritort të dënimit ligjor.

Në veçanti për këtë rast si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjykata pati parasysh pranimin e fajësisë, e këtë e ka shprehur që në fillim të seancës, duke cekur se ka gabuar, është penduar, jeton në kushte shumë të vështira ekonomike, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej këso vepra apo të tjera penale, shprehjen e keqardhjes si pendimin e shprehur për kryerjen e kësaj vepre penale. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata pati parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, peshën e veprës penale të kryer dhe mënyrën e kryerjes së saj, andaj edhe i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndaj të akuzuarit R.B., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit.

Gjykata, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjykata, bazuar në nenin 452 paragrafi 1 i KPPRK-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumën prej 20€ (Njëzetë euro), si dhe 20€ për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimin, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Pas shpalljes së aktgjykimit, në kuptim të nenit 367 të KPPRK-së palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2024:074776, 31.05.2024

G j y q t a r i

_____ Sadri Krasniqi,d.v.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.